



Bardhyl MAHMUTI

Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"



ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

KA A S'KA KUVEND?

FAQE 4-5



Një nga hartuesit e Kushtetutës së Kosovës, Ismet Salihu, ka thënë se Kuvendi nuk është konstituuar ende, pavarësisht se kryetari i tij thotë të kundërtën. "Konstituimi i Kuvendit të Kosovës ndodh vetëm kur

plotësohen të gjitha organet - kryetari, nënkryetarët dhe komisionet. Deri atëherë ky Kuvend nuk mund të konsiderohet i konstituuar", thotë Salihu. Ndërkaq Naim Rashiti, drejtor i Grupit Ballkanik

për Politika, konsideron se "të gjithë kanë bërë gabime". Sipas vlerësimit të tij, këto lëvizje janë bërë, në fakt, për ta vonuar konstituimin e Kuvendit dhe fillimin e procedurave për formimin e qeverisë së re

AMBASADORI AMERIKAN NË NATO: SHBA-ja DO STABILITET NË BALLKANIN PERËNDIMOR

F. 3



SPECIALJA PRET QË NË FUND TË DHJETORIT TË PËRMBYLLET GJYKIMI NDAJ ISH-KRERËVE TË UÇK-së

F. 5



RRETH 90 FERMERË KULTIVOJNË 100 HEKTARË ME ARONI

F. 8

RRITEN TË HYRAT E QEVERISË

F. 8

SPORT



'DARDANËT' VAZHDOJNË STËRVITJET, S'MUNGON OPTIMIZMI PËR NDESHJEN NDAJ ZVICRËS

F. 10

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@ml.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Specialja pret që në fund të dhjetorit të përmbillet gjykimi ndaj ish-krerëve të UÇK-së

HAGË, 2 SHTATOR - Paneli i gjyqtarëve i Dhomave të Specializuara të Kosovës në Hagë tha se mbrojtja e ish-krerëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës duhet të përgatitet për t'i paraqitur shkresat përfundimtare të gjykitimit para 22 dhjetorit të këtij viti. Në shkresën e publikuar më 2 shtator u tha se Zyra e Prokurorit të Specializuar mund të kërkojë që të paraqesë prova të tjera, sikurse edhe mbrojtja të paraqesë prova si kundërpërgjigje. Por, pa paragjykuar mundësinë e kërkesave të tilla, palët duhet të përgatiten që t'i paraqesin përmbledhjet përfundimtare deri më 22 dhjetor, raporton "Radio Evropa e Lirë".

Paneli i gjyqtarëve tha se parasheh që deri më 14 nëntor ose një javë pas përfundimit të dëshmisë së dëshmitarit të fundit të përmblyllë rastin e mbrojtjes të Hashim Thaçit dhe Jakup Krasniqit. "Paneli i njofton palët dhe pjesëmarrësit se duhet të jenë të përgatitur të paraqesin përmbledhjet përfundimtare të gjykitimit, si dhe deklaratën mbi ndikimin e krimeve të pretenduara te viktimat pjesëmarrëse në procedurë, para fillimit të pushimit gjyqësor, të hënën, më 22 dhjetor 2025", u tha në shkresë.

Ish-presidenti Hashim Thaçi, ish-kryeparlamentarët Kadri Veseli dhe Jakup Krasniqi dhe ish-deputeti i Kosovës, Rexhep Selimi, akuzohen për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit. Ata mohojnë akuzat.

Më 15 shtator, mbrojtja e ish-krerëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës do të nisë paraqitjen e provave.

Në konferencën e fundit statusore të mbajtur më 19 gusht, mbrojtja e

ish-presidentit të Kosovës, Hashim Thaçi, dhe ish-kryeparlamentarit Jakup Krasniqi, dhanë data të përafërta se kur mendojnë se do të përfundojnë paraqitjen e rastit të tyre.

Avokati i Thaçit, Lluka Mishetiq, tha se idealisht shpreson që të përfundojë me paraqitjen e provave dhe dëshmitarëve deri në fund të tetorit, apo më së largu deri në nëntor. Ndërkaq, mbrojtja e Krasniqit tha se parashikon se do t'i duhet një javë kohë për paraqitjen e provave dhe dëshmitarëve. Por, mbrojtja e Krasniqit do të nisë paraqitjen e rastit, pasi të ketë përfunduar ekipi mbrojtës i Thaçit.

Më 16 korrik 2025, ekipet mbrojtëse të Veselit dhe Selimit njoftuan se nuk synojnë të paraqesin ndonjë dëshmi mbrojtëse.

Në shkresën e panelit të gjyqtarëve të Dhomave të Specializuara - që njihen edhe si Gjykata Speciale - u paraqitën data kur mendohet se do të përmbillet rasti i mbrojtjes të Thaçit dhe Krasniqit. "Paneli vendos si datë të synuar për përfundimin e paraqitjes së mbrojtjes, si për mbrojtjen e Thaçit ashtu edhe atë të Krasniqit, 14 nëntorin 2025 ose një javë pas përfundimit të dëshmisë së dëshmitarit të fundit të mbrojtjes - cilado që të ndodhë më herët", u tha në shkresën e panelit të gjyqtarëve.

Paneli tha se kjo datë është vetëm një vlerësim i tij për kohëzgjatjen e çështjes së mbrojtjes dhe "mund të zgjatet, sipas nevojës".

Gjatë konferencës së fundit statusore, mbrojtja e Thaçit tha se do t'i duhen 35.5 orë për dhënien e dëshmive të dëshmitarëve për këtë rast.



Ndërkaq, mbrojtja e Jakup Krasniqit njoftoi se planifikon që dy dëshmitarë do të japin dëshminë në gjykatore, ndërkaq dy të tjerë do të japin dëshminë me shkrim dhe këto dëshmi veçse u janë dorëzuar prokurorëve.

Sipas kësaj përlogaritje, gjykatësi tha se do të duhen 35 ditë punë - pesë orë në ditë dëshmi - për përfundimin e dëshmitarëve, duke parashikuar se dëshmia e tyre mund të përfundojë në dhjetor.

Ndërkaq, në konferencën paraprake statusore, të mbajtur më 22 korrik, ekipet e mbrojtjes të ish-krerëve të UÇK-së u ankuan se nuk kishin kohë të mjaftueshme për përgatitjen e rastit të tyre.

Që nga 4 dhe 5 nëntori 2020 që të katër të akuzuarit ndodhen në paraburgim në Hagë, ku janë Dhomat e Specializuara të Kosovës.

Procesi gjyqësor ndaj tyre ka nisur

më prill të vitit 2023. Në mbi dy vjet, Zyra e Prokurorit të Specializuar thirrri në gjykatore 125 dëshmitarë si dhe ka paraqitur rreth 3 000 prova materiale.

ZPS-ja deklaroi më 16 prill se ka përmbyllur paraqitjen e provave ndaj ish-krerëve të UÇK-së.

Zyra e Prokurorit të Specializuar kishte konfirmuar aktakuzën ndaj ish-krerëve të UÇK-së në tetor të vitit 2020, por e bëri publike vetëm një muaj më vonë.

Aktakuza i ngarkon të akuzuarit për përgjegjësi "personale", por edhe për "krimet e kryera nga vartësit e tyre".

Sipas aktakuzës, Thaçi, Veseli, Selimi dhe Krasniqi akuzohen për krime kundër njerëzimit dhe krime lufte, përfshirë vrasjen e më shumë se 100 viktimave si dhe mbajtjen në paraburgim në mënyrë të paligjshme e torturimin e qindra viktimave.

Aktakuza thotë se katër të

akuzuarit dhe anëtarë të tjerë të UÇK-së ishin pjesë e një "ndërmarrjeje të përbashkët kriminale" dhe "kanë ndarë qëllimin e njëjtë për të marrë dhe ushtruar kontrollin në gjithë Kosovën me të gjitha mjetet, përfshirë edhe frikësimin, keqtrajtimin, ushtrimin e dhunës dhe eliminimin e atyre që i konsideronin kundërshtarë".

Dhomat e Specializuara dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar - të njohura gjerësisht si Gjykata Speciale - janë themeluar në vitin 2015 nga Kuvendi i Kosovës dhe janë pjesë e sistemit gjyqësor të Kosovës, por veprojnë me personel ndërkombëtar në Holandë.

Gjykata Speciale heton krimet e pretenduara të pjesëtarëve të UÇK-së, të kryera kundër pakicave etnike dhe rivalëve politikë që nga janari i vitit 1998 deri në dhjetor të vitit 2000.

OBSH: Një në çdo 100 vdekje në botë shkaktohet nga vetëvrasja

GENEVË, 2 SHTATOR - Më shumë se një në çdo 100 vdekje në botë është pasojë e vetëvrasjes, tha të martën Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH), duke bërë thirrje për veprime urgjente për të frenuar një krizë në rritje të shëndetit mendor, veçanërisht mes të rinjve.

OBSH tha se, megjithëse normat globale të vetëvrasjeve kanë rënë disi vitet e fundit, përparimi në luftën kundër këtij problemi ka qenë shumë i ngadalshëm, raporton AFP.

Në vitin 2021 - viti i fundit për të cilin ishin të disponueshme të dhëna - u regjistruan rreth 727 000 vetëvrasje në mbarë botën, tha Agjencia Shëndetësore e Kombeve të Bashkuara. "Globalisht, vetëvrasja përbën më shumë se një në çdo 100



vdekje, dhe për çdo vdekje ka 20 tentativa vetëvrasjeje", tha Devora Kestel, shefe e përkohshme e Departamentit për Sëmundjet jo të Transmetueshme dhe Shëndetit Mendor në OBSH.

Këto vetëvrasje "prekën shumë jetë dhe burime jetese të tjera, pasi miqtë, kujdestarët dhe të dashurit u detyruan të përballen me vështirësi të paimagjinueshme", u tha ajo gazetarëve.

Raporti "Shëndeti Mendor Botëror Sot" i OBSH-së theksoi se vetëvrasja mbetet një nga shkaqet kryesore të vdekjeve tek të rinjtë nëpër gjeografi dhe kontekste socio-ekonomike.

Në vitin 2021 ajo ishte shkaku i dytë kryesor i vdekjeve për vajzat dhe gratë e moshës 15 deri 29 vjeç, dhe shkaku i tretë për meshkujt në të njëjtën grupmoshë, thuhet në raport.

Megjithëse norma globale e vetëvrasjes sipas moshës ka rënë për 35 për qind ndërmjet viteve 2000 dhe 2021, bota është ende larg objektivit të saj: në vend të uljes për një të tretën të normave të vetëvrasjes ndërmjet 2015 dhe 2030, progresi aktual sugjeron se do të arrihet vetëm një ulje prej 12-përqindësh, sipas OBSH-së. Rënie u panë në çdo rajon -

përveç në kontinentin e Amerikës, ku norma e vetëvrasjes u rrit për 17 për qind në të njëjtën periudhë.

Gati tri të katërtat e të gjitha vetëvrasjeve ndodhin në vendet me të ardhura më të ulëta, ku jeton pjesa më e madhe e popullsisë globale.

Edhe pse vendet më të pasura kanë një normë më të lartë vetëvrasjesh, në raport me popullsinë, është e vështirë të krahasohet, pasi ato kanë të dhëna më të sakta se vendet me të ardhura të ulëta, theksoi OBSH.

Agjencia paralajmëroi se, ndërsa normat e vetëvrasjeve kanë qenë në rënie të ngadaltë, përhapja e çrregullimeve mendore, si ankthi dhe depresioni, është në rritje.

AMBASADORI AMERIKAN NË NATO: SHBA-ja DO STABILITET NË BALLKANIN PERËNDIMOR

BRUKSEL, 2 SHTATOR - Në një nga panelet e Forumit Strategjik të Bledit, ambasadori amerikan në NATO, Matthew G. Whitaker, tha se Shtetet e Bashkuara të Amerikës po ndjekin nga afër situatën në Serbi dhe në entitetin Republika Sërpska të Bosnjë-Hercegovinës, me synimin që të mos lejohet asnjë zhvillim që mund të çojë në konflikt rajonal. “Po ndjekim me shumë kujdes gjithçka që po ndodh si në Republikën Sërpska, ashtu edhe në Serbi. Aktualisht, jemi të përqendruar që situata të mos shndërrohet në një konflikt të mundshëm rajonal”, tha Whitaker.

Ai theksoi se ShBA-ja “do stabilitet në Ballkanin Perëndimor” dhe kjo, siç tha, është e rëndësishme edhe për partnerët evropianë brenda NATO-s, të cilët “e kanë detyrim të veprojnë së bashku në situata krize”.

Serbia ka qenë prej muajsh e përfshirë nga protestat antiqeveritare, të cilat shpesh janë shndërruar në episode dhune, ndërsa presidenti Aleksandër Vuçiq, pa asnjë provë, akuzon agjitorë të huaj për përpjekje për të nxitur revolucion. Në Republikën Sërpska,

Millorad Dodik sfidon vendimin e Gjykatës së Bosnjë-Hercegovinës për t’ia hequr mandatin presidencial pas një dënimi dhe vazhdimisht kërcënon me ndarjen e këtij entiteti nga pjesa tjetër e Bosnjës.

I pyetur nëse NATO-ja do të ndërhynte, nëse kriza politike do të përshkallëzohej në një konflikt të armatosur, sidomos në Bosnjë-Hercegovinë, por edhe në Serbi, Whitaker tha se NATO-ja vepron me unanimitet, por shtoi se “jemi shumë larg diçkaje të tillë”. “Nëse NATO-ja do të përfshihet... Rregulli numër 1 në politikë është të mos u përgjigjesh hipotezave. Mendoj se duhet të shohim se si do të zhvillohen gjërat”, tha Whitaker. “Ne do të vazhdojmë t’i inkurajojmë të gjitha palët që të punojnë në përputhje me marrëveshjet e Dejtonit”, tha ai, duke iu referuar marrëveshjeve që i dhanë fund luftës në Bosnjë në vitet ’90.

Ambasadori amerikan tha, po ashtu, se “NATO-ja është më e fortë se kurrë” dhe se “kjo duhet të jetë shumë shqetësuese për kundërshtarët tanë”.

Në pyetjen nëse presidenti amerikan, Donald Trump, mund të takohet me



presidentin serb, Aleksandar Vuçiq, ose me ish-presidentin e Republikës Sërpska, Millorad Dodik, Whitaker tha se për takime të tilla nuk ka asnjë paralajmërim, por se ato mund të diskutohen nëse do të kishte përfitime të qarta për paqen dhe stabilitetin. Ai tha se presidenti Trump ka një aftësi të veçantë për të komunikuar me liderë botërorë, për ta përdorur

ndikimin e presidencës amerikane dhe fuqinë e shtetit, në të mirë të paqes, demokracisë, stabilitetit dhe zhvillimit ekonomik.

Ai theksoi se nëse Trumpi do të vendoste të takohet me Vuçiqin ose Dodikun, një gjë e tillë nuk do të bëhej për ta forcuar pozitën e tyre politike, por vetëm nëse do të shërbente për avancimin e interesave më të gjëra të paqes

dhe stabilitetit. “Sigurisht që nuk do të pranonte një takim që synon forcimin e pozicionit politik të ndonjë udhëheqësi. Kjo nuk është ajo që bën presidenti Trump”, tha ambasadori amerikan. Ai e përshkroi Trumpin si “paqebërës”, duke theksuar se politika e tij fokusohet në rezultate dhe në krijimin e mundësive për përparim.

BDI-ja: VLEN PREMTOI EVROPËN, SOLLI ‘BOTËN SERBE’

PRISHTINË, 2 SHTATOR - Bashkimi Demokratik për Integritim (BDI) ka theksuar se VLEN-i erdhi në pushtet me premtime të mëdha dhe me afate strikte për ndryshimet kushtetuese. “Fillimisht u zotuan se kjo do të bëhej para formimit të qeverisë, më pas thanë brenda 100 ditëve. Pastaj brenda tre muajve. Në fund, brenda gjashtë muajve. Sot, pas një viti, shqiptarët dëgjojnë vetëm justifikime nga Izet Mexhiti dhe shokët e tij se ‘koha nuk ka mjaftuar’”, thuhet në reagimin e BDI-së. Sipas BDI-së, e vërteta është e thjeshtë: “nuk kanë as vizion, as guxim, as vullnet politik. Në vend të ndryshimeve kushtetuese dhe integritimit evropian, VLEN ka hapur derën për ndikime të rrezikshme nga Beogradi dhe



Moska, duke minuar Marrëveshjen Paqësore të Ohrit, duke e zbehur pozitën e

shqiptarëve dhe duke e vonuar të ardhmen evropiane të vendit”. “Ky pushtet është shndërruar në

simbol të dështimeve dhe skandaleve të përditshme. Mashtimet elektorale janë bërë norma e tyre e vetme e qeverisjes: Premtuan 2 500 vende pune - qytetarët morën zhgënjim. Premtuan mbështetje financiare për të rinjtë - qytetarët morën zero. Premtuan projekte kombëtare - sollën Ivan Stoilkoviçin si zëvendëskryeministër për implementim të Marrëveshjes së Ohrit. Premtuan ndryshime kushtetuese dhe rrugë drejt BE-së - sollën partneritete me politikanë që propagandojnë ‘Botën Serbe’. Siç e ka theksuar ish-ministri i Jashtëm, Bujar Osmani, shmangia e debatit për BE-në dhe refuzimi i mekanizmave të monitorimit nuk janë rastësi, janë strategji për

ta fshehur korrupsionin dhe dështimet e kësaj qeverie dhe për ta penguar barazinë e shqiptarëve”, ka theksuar BDI. “VLEN është dëshmuar si mashttrim politik dhe turp kombëtar që po e izolon vendin dhe po i përjashton shqiptarët nga proceset vendimmarrëse. Tetori do të jetë momenti kur qytetarët do t’u thonë ‘mjaft’ mashttimeve, dështimeve dhe shërbimeve të verbra ndaj interesave të huaja. Qytetarët meritojnë përfaqësim dinjitoz dhe vizion të qartë evropian, jo premtime boshe dhe arsyetime qesharake. Ata do ta manifestojnë vullnetin e tyre në referendumin popullor të tetorit. Askush nuk mund t’i shmanget përgjegjësisë politike dhe juridike”, ka theksuar BDI-ja.

Ish-deputeti i PD-së i bashkohet ekipit të Vjosa Osmanit

PRISHTINË, 2 SHTATOR - Ish-deputeti i Partisë Demokratike, Kreshnik Çollaku, ka njoftuar se, pas largimit nga Parlamenti i Shqipërisë, do të nisë një kapitull të ri në karrierën e tij politike, duke iu bashkuar ekipit të presidentes së Kosovës, Vjosa Osmani. “Të dashur miq, me kënaqësi dhe krenari kam pranuar ftesën e presidentes së

Kosovës, Vjosa Osmani, për t’u bërë pjesë e ekipit të saj në pozicionin e këshilltarit për politikë të jashtme. Dëshira dhe vullneti im për t’i shërbyer Kosovës si pjesë thelbësore e çështjes kombëtare shqiptare, me këtë angazhim merr një dimension e mundësi të re, për të cilën i jam mirënjohës e falënderues presidentes

Osmani për besimin dhe vlerësimin. Ky angazhim me jep një mundësi të shkëlqyer për të qenë midis Tiranës e Prishtinës, me të njëjtin angazhim politik e publik, dhe vullnet për të kontribuar avancimit në mënyrë të integruar të interesave tona kombëtare e shtetërore”, ka shkruar Çollaku në “Facebook”.





KA A S'KA KUVEND?

Një nga hartuesit e Kushtetutës së Kosovës, Ismet Salihu, ka thënë se Kuvendi nuk është konstituuar ende, pavarësisht se kryetari i tij thotë të kundërtën. “Konstituimi i Kuvendit të Kosovës ndodh vetëm kur plotësohen të gjitha organet - kryetari, nënkryetarët dhe komisionet. Deri atëherë ky Kuvend nuk mund të konsiderohet i konstituuar”, thotë Salihu. Ndërkaq Naim Rashiti, drejtor i Grupit Ballkanik për Politika, konsideron se “të gjithë kanë bërë gabime”. Sipas vlerësimit të tij, këto lëvizje janë bërë, në fakt, për ta vonuar konstituimin e Kuvendit dhe fillimin e procedurave për formimin e qeverisë së re

PRISHTINË, 2 SHTATOR - Për njërin nga hartuesit e Kushtetutës së Kosovës, Ismet Salihun, Kuvendi nuk është konstituuar ende, pavarësisht se kryetari i tij thotë të kundërtën. “Konstituimi i Kuvendit të Kosovës ndodh vetëm kur plotësohen të gjitha organet - kryetari, nënkryetarët dhe komisionet. Deri atëherë, ky Kuvend nuk mund të konsiderohet i konstituuar”, thotë Salihu për Radion Evropa e Lirë. Kryekuvendari Dimal Basha e shpalli të mbyllur seancën konstituive më 30 gusht, edhe pse nënkryetari serb nuk ishte zgjedhur. Nga pesë nënkryetarët e kërkuar me Kushtetutë, katër u zgjodhën - tre shqiptarë dhe një përfaqësues i pakicave joserbe - ndërsa i pesti, nga komuniteti serb, nuk arriti t'i siguronte votat e mjaftueshme. Basha tha se të gjitha mundësitë për zgjedhjen e tij janë shteruar dhe se seanca mund të konsiderohet e përfunduar. “Për mua nuk ka logjikë që të bllokohet Kuvendi i Republikës për moszgjedhjen e një nënkryetari”,

përsëriti ai më 1 shtator. Pas krijimit të kësaj situatë, Salihu sugjeron të pritët zgjidhje nga Gjykata Kushtetuese. Më 30 gusht Lista Serbe - partia më e madhe serbe në Kuvend - paraqiti ankesë në Kushtetuese për mënyrën e votimit të nënkryetarit serb, duke kritikuar veprimin e Bashës që i hodhi në votim ndaras nënkryetarët e pakicave dhe përdori shortin për kandidatët serbë. “Kushtetuta është shumë e qartë: grupi më i madh parlamentar i partive të komunitetit serb ka të drejtën të propozojë kryetarin ose nënkryetarin e Kuvendit”, shpjegon Salihu. “Prandaj, serbëve u është bërë një padrejtësi, sepse nënkryetarin nga komuniteti serb kishte të drejtë ta propozonte vetëm Lista Serbe, pa marrë parasysh se a duam a nuk duam ne”, shton ai. Lista Serbe propozoi vetëm Sllavko Simiqin për nënkryetar, por ai nuk arriti t'i siguronte 61 votat e nevojshme në asnjë nga tri raundet e votimit, ndaj Basha përdori shortin për të dhjetë

deputetët serbë - nëntë nga Lista Serbe dhe një nga Partia për Liri, Drejtësi dhe Mbijetesë. Naim Rashiti, drejtor i Grupit Ballkanik për Politika, konsideron se “të gjithë kanë bërë gabime”. “Në parim, procedura është shkelur edhe nga kryetari i Kuvendit, edhe nga përfaqësuesit serbë, sepse nuk kanë vazhduar me propozime, sipas rregullit të përcaktuar nga Gjykata Kushtetuese. Tani asgjë... Na mbetet të presim vendimin e Gjykatës Kushtetuese, e cila besoj se do ta kthejë procesin e votimit për përfaqësuesit e komuniteteve në Kryesinë e Kuvendit... e sa do të zgjasë kjo, nuk e di”, thotë Rashiti për Radion Evropa e Lirë. Sipas vlerësimit të tij, këto lëvizje janë bërë, në fakt, për ta vonuar konstituimin e Kuvendit dhe fillimin e procedurave për formimin e Qeverisë së re. “Që nga fillimi ka ekzistuar e njëjta strategji: vonimi i proceseve për të siguruar një shumicë ndryshe parlamentare, duke krijuar rrethana që eventualisht do të favorizonin mbështetje më të

madhe politike për një subjekt të caktuar, në këtë rast - kryesisht - për fituesen e zgjedhjeve, Lëvizjen Vetëvendosje”, thotë Rashiti. Dyshime të ngjashme janë shfaqur më herët edhe nga vëzhgues të tjerë, pasi Lëvizja Vetëvendosje e kryeministrit në detyrë, Albin Kurti, nuk ka siguruar mjaftueshëm vota në zgjedhjet e 9 shkurtit për të qeverisur e vetme. Rashiti thotë se këto “manovra politike” kanë ndodhur edhe në të kaluarën, por “kanë qenë më transparente”. “Kam përshtypjen se të gjithë janë të vetëdijshëm se procedua [e konstituimit të Kuvendit] nuk është mbyllur dhe askush nuk do ta marrë veprimin për formimin e Qeverisë”, thotë ai. Me ligj, presidentja e vendit, Vjosa Osmani, duhet të mandatojë partinë ose koalicionin fitues për formimin e Qeverisë, pas konstituimit të Kuvendit. Pas një takimi që zhvilloi më 1 shtator me kryekuvendarin Basha, zyra e saj tha se “ekipi ligjor i Presidencës është duke bërë analizën lidhur me procesin e konstituimit të Kuvendit të Kosovës”. Por, Zahir Çerkini, profesor i së Drejtës Kushtetuese në Universitetin “Isa Boletini” në Mitrovicë, konfirmon po ashtu se Kuvendi nuk është plotësisht i konstituuar pa zgjedhjen e të gjithë nënkryetarëve. “Neni 67 i Kushtetutës e thotë shprehimisht se Kryesia e Kuvendit përbëhet

nga kryetari dhe pesë nënkryetarë, përfshirë detyrimisht një nga komuniteti serb dhe një nga komunitetet tjera joshumicë”, thekson Çerkini për Radion Evropa e Lirë. “Rregullorja e Kuvendit e konfirmon se seanca konstituive nuk mund të quhet e përfunduar pa këtë hap. Kjo çështje është përcaktim i qartë kushtetues”, sipas tij. Për konstituimin e plotë të Kuvendit, që nga 15 prilli, janë ndërmarrë dhjetëra përpjekje, por pa rezultat, për shkak të mosmarrëveshjeve politike. Çështja është dërguar edhe në Gjykatën Kushtetuese, e cila ka dhënë dy vendime me afate dhe udhëzime për zhvillimin e procesit. Afati i parë nuk u respektua, ndërsa i dyti skadon më 18 shtator. Më 1 shtator Basha thirri një mbledhje të Kryesisë së Kuvendit për t'u konsultuar mbi funksionimin e institucionit, por ajo nuk u zhvillua për shkak të mungesës së kuorumit. Dy nënkryetarë të partive ish-opozitare, që nuk pajtohen me vendimin e Bashës për seancën konstituive, nuk morën pjesë. “Kuvendi ka zgjedhur kryetarin dhe katër nënkryetarët. Kryesia e Kuvendit ka të zgjedhur pesë nga gjashtë anëtarët e saj. Mbi 80 për qind e Kryesisë është funksionale dhe besoj se kemi kuorumin e mjaftueshëm për të vazhduar punët tona”, këmbënguli Basha.

PËRFAQËSUESIT E LV-së NË KQZ KRITIKOJNË QUINT-in PËR 'MBËSHTETJEN E LISTËS SERBE'



PRISHTINË, 2 SHTATOR - Përfaqësuesit e Lëvizjes Vetëvendosje në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve kanë kritikuar vendimin për certifikimin e Listës Serbe për zgjedhjet lokale të tetorit, teksa Alban Krasniqi nga ky subjekt kritikoi ambasadat e shteteve të QUINT-it, duke thënë se ato u kanë dalë në mbrojtje "organizatave kriminale".

Krasniqi nga LV tha gjatë mbledhjes së KQZ-së më 1 shtator se, pavarësisht prej vendimit të formës së prerë nga Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa, por edhe të Gjykatës Supreme, ai mendon se me certifikimin e Listës Serbe për zgjedhjet e 12 tetorit do të dëmtohet demokracia. "Në komunat ku Lista Serbe pretendon të garojë, aty nuk do të ketë demokraci. E dinë prej ambasadorit e përfaqësuesit të BE-së, e gjithë këta të tjerët që janë të QUINT-it, e dinë shumë mirë sepse vetë e kanë deklaruar me radhë. Por, edhe ata fatkeqësisht janë duke u vënë në mbrojtje të organizatave kriminale në vend për hesape të tyre të ngushta apo edhe të karrierës së tyre politike", tha Krasniqi.

Sipas tij, me certifikimin e Listës Serbe kanë dështuar institucionet e drejtësisë, por qeveria dhe organet e sigurisë kanë kryer punën e tyre. "Për

mua Lista Serbe vazhdon të jetë një organizatë kriminale, me baza dhe përmasa të një organizimi terrorist dhe unë nuk mund ta pranoj si pjesë të sferës politike", tha ai.

Më 21 gusht KQZ-ja vendosi për moscertifikimin e Listës Serbe, partisë kryesore të serbëve në Kosovë që gëzon mbështetjen e Beogradit zyrtar. Në atë mbledhje, Kurteshi dhe Krasniqi ishin të zëshëm kundër certifikimit të Listës Serbe, duke argumentuar se shumica e kandidatëve të saj janë pjesë edhe e strukturave paralele serbe, por e cilësuan këtë parti edhe si "dorë e zgjatur" e presidentit serb, Aleksandër Vuçiq, në Kosovë.

Më 24 gusht PZAP-i urdhëroi që KQZ-ja të certifikonte Listën Serbe për zgjedhjet e tetorit, duke argumentuar se ky subjekt i ka përmbushur të gjitha detyrimet pasi ka paraqitur dokumentacionin e kërkuar, përfshirë deklaratën politike, kodin e sjelljes, listën e kandidatëve dhe formularët për konfirmimin e kandidatëve.

Vendimi i KQZ-së i 21 gushtit, për moscertifikimin e Listës Serbe ishte kritikuar nga vendet e QUINT-it dhe Bashkimi Evropian, të cilat i bënë thirrje Qeverisë në detyrë dhe partive politike të mos ndërmarrin ndonjë hap tjetër për ta penguar regjistrimin e Listës Serbe për

zgjedhjet e tetorit. "Unë mendoj që institucioni jonë [KQZ-ja], PZAP-ja dhe Gjykata Supreme në këtë rast janë bërë pjesë e një vendimmarrje e cila do ta dëmtojë rëndë demokracinë, edhe e cenon rendin kushtetues dhe është ironike që institucionet të tilla që do të duhej të ishin në mbrojtje, të bien në kundërshtim dhe lajthitje. Por, nuk mendoj që është lajthitje, por një vendimmarrje e qëllimshme si rezultat i presioneve, as të ambasadorëve ndoshta jo, të do diplomatëve që vijnë e sillen këndej, e do shërbëtorëve të tyre që vijnë e sillen poshtë e lartë e i bëjnë presion si ndonjë kryetari të partisë, ashtu edhe zyrtarëve të cilët i ngashënjën me ndonjë punëtor jashtë vendit e kështu me radhë", tha Krasniqi.

Më 29 gusht, ndërkaq, Gjykata Supreme e hodhi poshtë "si të palejuar" ankesën e paraqitur nga Krasniqi dhe përfaqësuesi tjetër i LV-së në KQZ, Sami Kurteshi sa i përket vendimit të PZAP-it.

Gjatë mbledhjes të KQZ-së, Kurteshi se i konsideron të "kundërligjshme dhe kundërkushtetuese" vendimet e PZAP-it dhe Gjykatës Supreme sa i përket Listës Serbe. "Për më shumë, Supremja ka bërë një rrëshqitje shumë të madhe, i delegitim anëtarët e KQZ-së që e kanë kompetencë ligjore të

votojnë për certifikimin ose kundër certifikimit, i delegitim për ankesë, kurse Listën Serbe e legjitim për ankesë", tha ai.

Supremja u kundërpërgjigjet akuzave të Krasniqit

Gjatë mbledhjes së KQZ-së, Alban Krasniqi ka hedhur akuza edhe ndaj Gjykatës Supreme, e cila i është kundërpërgjigjur. Krasniqi tha se për çështjen e Listës Serbe i kishte dërguar email edhe gjyqtarit të Supremes, Zenel Leku. "Unë po e bëj publike, kam dërguar email zyrtar tek ai personi që e ka emrin gati si Zllatan Ellek [kryetari i Listës Serbe], por ashtu doli edhe me mënyrën se si ka dirigjuar me këtë proces - Zenel Leku apo kush është kryesuesi [i Supremes]", tha Krasniqi. Kjo deklaratë nxiti kryetarin e KQZ-së, Kreshnik Radoniqi, që t'i kërkonte Krasniqit të mos flasë për njerëz të tjerë pa fakte.

Krasniqi pretendoi se Zenel Leku nuk i është përgjigjur në emailin, ku tha se ka ofruar fakte për moscertifikimin e Listës Serbe, duke shtuar se ai ka frikë edhe të kthejë përgjigje sepse "dikush atje shkon e shtrëngon apo ka interesa bashkë me ata të tjerë".

Në një reagim të Supremes, të

publikuar mbrëmjen e 1 shtatorit, gjykata shprehu "shqetësim të thellë me sulmet e fundit" të Krasniqit, duke thënë se ai ka përdorur gjuhë të papranueshme ndaj këtij institucioni dhe gjyqtarit Leku. "Gjykata Supreme dënon ashpër këtë gjuhë reagimi të paprecedent dhe konsideron se deklaratat e tilla, përveçse janë të papranueshme, përbëjnë sulm të drejtpërdrejtë ndaj integritetit të një gjyqtari dhe sistemit të drejtësisë në Kosovë". Sipas Supremes, "lakimi dhe krahasimi i emrit të gjyqtarit Zenel Leku është tentativë e ulët për ta dëmtuar figurën e tij dhe për ta minuar besimin në drejtësi".

Edhe për zgjedhjet e përgjithshme të shkurtit, anëtarët e LV-së kishin kundërshtuar certifikimin e Listës Serbe. Por, PZAP-i dhe Supremja hodhën poshtë ankesat e tyre.

Lista Serbe vendosi të garojë në zgjedhjet e sivistshme lokale, pasi kishte bojkotuar zgjedhjet e kaluara lokale, duke bërë që kryetarët shqiptarë ta merrnin dhe mbanin pushtetin në katër komunat me shumicë serbe në veri të vendit nga maji i vitit 2023.

Lista Serbe pritet t'i rimarrë të gjitha katër komunat veriore: Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Zvečan dhe Zubin Potok.

Kryeziu: Kriza është kthyer në normalitet, kjo situatë do të duhej të ishte alarmante për partitë

PRISHTINË, 2 SHTATOR - Drejtori i KDI-së, Ismet Kryeziu, ka reaguar në lidhje me situatën politike në vend, duke thënë se Kosova gjendet në një krizë të thellë. Në "Facebook", ai ka shkruar se kriza institucionale është kthyer në normalitet. "48-orëshi i

Kuvendit tani u harrua!? Situata politike është futur në krizë të thellë: disa po e luajnë kryetarin e Kuvendit, të tjerët po e trajtojnë Kuvendin si të pakonstituuar. Tani as kalendari për krijimin e qeverisë nuk po ecën dhe as puna e Kuvendit. Arritën ta

kthejnë krizën politike e institucionale në normalitet. Kjo situatë do të duhej të ishte alarmante për partitë politike, por ato po i shkelin interesat e Republikës dhe po e lënë vendin pa institucione, vetëm për të ruajtur interesat e tyre partiake", ka thënë Kryeziu.



GRUPET KRIMINALE NGA BALLKANI PO E ZGJEROJNË ROLIN E AFRIKËS PERËNDIMORE NË TREGTINË E KOKAINËS, THOTË NJË RAPORT

PRISHTINË, 2 SHTATOR - Grupet kriminale nga Ballkani Perëndimor, të cilat janë ndër trafikantët kryesorë të kokainës në Evropë, po konsolidojnë praninë e tyre në Afrikën Perëndimore, duke e shndërruar rajonin në një hallkë gjithnjë e më të rëndësishme të itinerarit të kontrabandës nga Amerika Latine drejt Bashkimit Evropian, thuhet në një raport të ri. Kërkesa në rritje për kokainë në Evropë, së bashku me shtimin e kontroleve në rrugët direkte nga Amerika Latine dhe zgjerimi i konsiderueshëm i porteve detare në Afrikën Perëndimore, ka shtyrë kontrabandistët prej disa vitesh ta rrisin trafikun përmes Senegalit, Sierra Leones, Gambias, Guinea-Bisaut dhe Kepit të Gjelbër. Por, ndikimi i rrjeteve shqiptare dhe atyre sllavishtfolëse në rajon deri më tani është kuptuar pak. Hulumtuesit e Iniciativës Globale kundër Krimit të Organizuar Transnacional (GI-TOC), në raportin e publikuar të martën, thanë se këto grupe janë rritur dukshëm në rëndësi



globale dhe tashmë janë mes rrjeteve më të mëdha kriminale në tregtinë e kokainës në Evropë. Ato kanë shfrytëzuar aleancat në rajon me grupe

kriminale holandeze dhe sidomos me organizatën braziliane Primeiro Comando da Capital (PCC), për ta thelluar kontrollin mbi zinxhirin e

furnizimit. "Aleanca mes grupeve nga Ballkani Perëndimor dhe PCC-së është, ndoshta, partneriteti më i rëndësishëm aktualisht për

futjen e kokainës në Evropë", tha Sasha Gjirgeviq, një nga autorët dhe analist i lartë në GI-TOC. Raporti, pjesërisht i mbështetur nga qeveria britanike, thekson se nevojitet më shumë bashkëpunim ndërkontinental mes agjencive të rendit, autoriteteve portuale dhe aktorëve të tjerë për të luftuar këto rrugë gjithnjë e më të zgjeruara të drogës. Ai bën thirrje, gjithashtu, për mbledhje më të gjerë të të dhënave dhe shënjestrim më të mençur të ndërmjetësve në këtë tregti. "Këto grupe janë ndër më të sofistikuarat në botë - nuk janë lojtarë periferikë", tha Lucia Bird Ruiz-Benitez de Lugo, drejtoreshë e Observatorit të Ekonomive të Paligjshme në Afrikën Perëndimore pranë GI-TOC. "Këta aktorë të mëdhenj globalë lidhen me dhunë në Evropë, dhe ndërsa gjithnjë e më shumë rrjete kriminale tepër të sofistikuara e të dhunshme depërtojnë në Afrikën Perëndimore, kjo paraqet rrezik serioz për stabilitetin dhe sigurinë".

IKSHPK: UJI NGA LIQENI I BADOCIT TË MOS PËRDORET PËR PIJE



PRISHTINË, 2 SHTATOR - Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) u ka bërë thirrje qytetarëve që furnizohen me ujë nga Liqeni i Badocit që të mos e përdorin atë për pije, për faktin se IKShPK, gjatë monitorimit për cilësinë e ujit të pijshëm, "ka vërejtur ngritje të vlerave të manganit në mostrat e ujit në zonën e cila furnizohet nga liqeni akumulues i Badocit". "IKShPK thekson se ndotja e ujit me mangan është ndotje kimike dhe se vlimi i ujit nuk e eliminon manganin. Uji mund të përdoret vetëm për pastrim, mirëmbajtjen

e higjienës personale dhe të ambienteve të banimit", u tha në njoftim. Duke paraqitur hartën e pjesëve që furnizohen me ujë nga Badoci, IKShPK tha se qytetarëve të prekur do t'u sigurohet furnizim i pandërprerë me ujë të pijshëm nga Ujësjellësi Rajonal "Prishtina" përmes autoboteve. Edhe në të kaluarën IKShPK-ja ka rekomanduar disa herë mospërdorimin e ujit të Badocit për pije për shkak të rritjes së vlerave të manganit. Mangani konsiderohet se kontribuon në shumë funksione

trupore, përfshirë metabolizmin e kolesterolit, të glukozës e të karbohidrateve, në formim të kockave, në mpiksjen e gjakut dhe në reduktimin e inflamacionit. Por, sasia e tepruar e tij rrezikon kryesisht fëmijët nën 5 vjeç, pasi nga ekspozimi afatgjatë mund të përballen me probleme me kujtesë dhe përqendrim. Përveç ujit, mangani gjendet edhe në ajër dhe shumë ushqime, përfshirë drithërat, fasulet, arrat dhe çajin, gjithmonë në vlera të pranueshme për trupin e njeriut.

Berisha: Zgjedhja e kryetarit të Kuvendit me të gjitha këto mangësi do të na izolojë tërësisht

PRISHTINË, 2 SHTATOR - Ish-deputeti i PDK-së, Hisen Berisha, ka reaguar ndaj zgjedhjes së kryetarit të ri të Kuvendit të Kosovës, Dimal Basha, duke ngritur shqetësime për ndikimin që

kjo do të ketë në marrëdhëniet me aleatët ndërkombëtarë. Ai ka paralajmëruar se Kosova do të izolohej tërësisht nga zgjedhja e kryeparlamentarit, me të gjitha këto mangësi që janë

shfaqur gjatë zgjedhjes së tij. "Zgjedhja e kryetarit të Kuvendit, me të gjitha këto mangësi që i ka në integritetin e vet, do të jetë një përfaqësim që do ta determinojë qasjen e aleatëve ndërkombëtarë ndaj

Kosovës për të gjitha çështjet që i ka, ashtu siç ka ndodhur me Kurtin. Do të na izolojë tërësisht, do të na dërgojë edhe në izolim më të thellë", ka thënë Berisha në emisionin "Mesditë" në "tëvë1".



Gërvalla dhe Fajon diskutojnë për finalizimin e procesit të njohjes së patentëshoferëve të Kosovës në Slloveni

PRISHTINË, 2 SHTATOR - Në kuadër të punimeve të Forumit Strategjik të Bledit, zëvendëskryeministria dhe ministria në detyrë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, Donika Gërvalla, zhvilloi një takim me zëvendëskryeministren dhe ministren e Punëve të Jashtme dhe Evropiane të Sllovenisë,

Tanja Fajon. Në takim u diskutua për thellimin e bashkëpunimit ekonomik dhe nxitjen e lidhjeve në mes të bizneseve të të dyja vendeve, si një hap i rëndësishëm për ndërtimin e një partneriteti të qëndrueshëm dhe afatgjatë ndërmjet Kosovës dhe Sllovenisë. Një tjetër temë me rëndësi ishte

finalizimi i procesit të njohjes së patentëshoferëve të Kosovës në Slloveni, që do ta lehtësojë ndjeshëm jetën e mërgatës sonë dhe do t'i forcojë edhe më tej lidhjet ndërmjet dy vendeve. Ministria Gërvalla falënderoi ministren Fajon për mbështetjen e vazhdueshme të Sllovenisë ndaj Kosovës në procesin e

integritetit euroatlantik, duke e vlerësuar këtë mbështetje si dëshmi të rolit të Sllovenisë si një mike dhe partnere e vendit tonë. "Mbështetja e palëkundur e Sllovenisë për integritetin euroatlantik të Kosovës riafirmon rolin e saj si një aleate dhe partnere strategjike e vendit tonë", theksoi ministria Gërvalla.



KËRKIMFALJA E DIMAL BASHËS DHE FALSIFIKATORJA JANA ARSOVSKA



Bardhyl MAHMUTI

Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Dimal Basha, kërkoi publikisht falje për përmendjen e emrit të tij si bashkautor i një artikulli, ku lufta çlirimtare e Kosovës prezantohet sipas interpretimeve të sajara nga Shërbimi Sekret i Serbisë në të ashtuquajturat "libra të bardhë".

Nuk dëshiroj të lëshohem në aspektin e kërkesës për falje, por e shoh të udhës të vë theksin në një

fakt shumë të rëndësishëm për çështjen tonë:

Nëse profesoresha e kriminologjisë ndërkombëtare në John Jay College of Criminal Justice, në kuadër të Universitetit të "City University of New York (CUNY)", Jana Arsovska ka futur emrin e studentit Dimal Basha si bashkautorë, në një punim "shkencor", pa kërkuar miratimin paraprak të tij, atëherë ajo ka bërë

një shkelje të serioze etike në rrafshin akademik duke falsifikuar autorësinë e një "studimi".

Prandaj, që të merret seriozisht pretendimi i Dimal Bashës se nuk ka qenë në dijeni për publikimin e emrit të tij si bashkautorë në "studimin" e lartpërmendur, ai duhet të kërkojë nga Komisioni i Etikës në universitetin ku ligjëron Jana Arsovska që të merren masat disiplinore ndaj saj për

falsifikimin që ka bërë.

Në të kundërtën, nëse nuk e bën publike kërkesën drejtuar Komisionit të Etikës për falsifikim, kërkesa publike për falje është sa për t'u hedhur hi syve atyre që kanë shprehur revoltë për përmbajtjen e paçavures me titull "Globalizing the Western Balkans: Transnational Crime, Fundamental Islam and Unholy Alliances".

HAZIRI: PËR 6 VJET ALBIN KURTI I PËRJASHTOI GJILANIN DHE ANAMORAVËN NGA INVESTIMET

PRISHTINË, 2 SHTATOR - Nën kryetari i Lidhjes Demokratik të Kosovës, deputeti Lutfi Haziri, e ka kritikuar qeverinë Kurti për diskriminim të rajonit të Anamoravës. Ai ka bërë me dije se për gjashtë vjet Albin Kurti i ka përjashtuar Gjilanin dhe Anamoraven nga investimet. Në "Facebook", Haziri ka treguar se si është trajtuar ky rajon nga qeveria aktuale. "Për 6 vjet Albin Kurti e përjashtoi Gjilanin dhe Anamoraven nga investimet - ku prekën, e shkretuan! Për më keq, ai i ndali 114 milionë investime të zotuar nga ne. Për 4 vite, bedeli i tij në Gjilan dështoi edhe në një projekt të vetëm. Projekti quhet rrizhullimi i Bulevardit 'Ibrahim Rugova'. Pse në asnjë rast nuk e përmendët?! A keni tregu se çka bëni me shtatorët e Mulla Idriz Gjilanit, Kadri Zekës e Ramiz Cernices? Ku zhvendosen dhe pse duhet të zhvendosen? Nuk bëhet hajgare me qytetarët e gjallë e kurrë me shtatorët e kolosëve të vendit", ka shkruar ai.

"E tani? Tani më 1 shtator në vend që fëmijët dhe prindërit të gëzohen me çerdhe të reja, hapësira shkollore apo vetë librat e garantuara, ata zgjedhën



të mashtrojnë prapë. Para Kuvendit, filluan inagurimin e rrizhullimit të një copë qendre në kundërshtim me PZHK-në dhe planet urbane. Pa leje pune dhe pa buxhet të garantuar, premtuan tunel nëntokësor në zemër të qytetit. Për më keq, paralajmëruan pa leje pune, pa leje rrënimi e ndërtimi, që

vazhdojnë me mashttrim. Duam Autostradën, Impiantin për trajtimin e ujërave të zeza, rrugën e Prishtinës, Parkun e Paqes, çerdhen në 'Arbëri', rrugën për Viti, rrugën e Kumanovës e shumë projekte tjera, të cilat i ndaluar në zbatim. Duhet të jepni llogari, përse nuk i keni bërë. Pse e dëmtuat deri në

stërkeqje rrugën 'Adem Jashari' dhe 'Hamdi Kurteshi'? Ku keni prek, keni shkretu dhe e keni kthyer Gjilanin në grope të zezë financiare e avari administrative. Këto janë vepra penale që nuk mund t'i shpëtoni me kohë", ka shkruar ai, duke thënë se kandidati i LDK-së për kryetar të Gjilanit është shpresë

për qytetarët e kësaj komune. "Mos ta harrojmë Stadiumin e Qytetit, i cili do të duhej të ishte i gatshëm tashmë për Ligën e Konferencës. Mashtrimi nuk kalon! Gjilanasit u dhanë një copë besimi, por e nëpërkëmbët për toke. Arbëri po vjen. LDK, më 12 tetor, besë e shpresë!", ka shkruar Haziri.

Osmani: Bashkëpunimi me KFOR-in, garanci për stabilitetin në Kosovë

PRISHTINË, 2 SHTATOR - Presidentja e Republikës së Kosovës, Vjosa Osmani, ka takuar komandantin e KFOR-it, gjeneralmajor Enrico Barduani, me të cilin ka biseduar për zhvillimet më të

fundit të sigurisë në vendin tonë.

Në vazhde të takimeve të rregullta me komandantin e KFOR-it, si dhe në prag të përfundimit të mandatit të tij, presidentja Osmani shprehu mirënjohje për

angazhimin e pandërprerë të tij dhe të ushtarëve të KFOR-it në mirëmbajtjen e paqes dhe të sigurisë në Kosovë në bashkëpunim me institucionet e sigurisë në Kosovë. Ajo ritheksoi rëndësinë e

vazhdimin të bashkëpunimit të ngushtë në mes të institucioneve tona të sigurisë dhe KFOR-it, si garanci për stabilitetin dhe sigurinë e të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës.



Rriten të hyrat e qeverisë

PRISHTINË, 2 SHTATOR - Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK) ka publikuar llogaritë qeveritare për tremujorin e dytë (TM2) 2025. Ky publikim paraqet pasqyrën e të hyrave dhe shpenzimeve qeveritare brenda kësaj periudhe. Gjithsej të hyrat e Qeverisë së

Përgjithshme në TM2 2025 ishin 972.6 milionë euro, derisa të hyrat në TM2 2024 ishin 782.6 milionë euro. Pjesën më të madhe të të hyrave e përbëjnë: tatimet në produkte që paraqesin 64 %; tatimet rrjedhëse në të ardhura (16 %); aktivet dhe detyrimet financiare

(10 %). Pjesa e mbetur është shpërndarë në kategori të tjera të të hyrave. Gjithsej shpenzimet e Qeverisë së Përgjithshme në TM2 2025 ishin 784.9 milionë euro, ndërsa shpenzimet në TM2 2024 ishin 679.1 milionë euro. Pjesën më të madhe të

shpenzimeve e përbëjnë: kompensimi i punëtorëve (28 %); kontributet sociale dhe përfitimet (26 %); formimi i kapitalit bruto (15 %); dhe konsumi i ndërmjetëm (14 %). Pjesa e mbetur e shpenzimeve është shpërndarë në kategori të tjera të shpenzimeve.



PAS AKTGJYKIMIT QË ANULOI VENDIMIN E ZRRE-së, BIZNESET MENDOJNË PËR PADI EDHE NDAJ KEK-ut

PRISHTINË, 2 SHTATOR - Pak ditë pasi morën faturat e muajit qershor, në mesin bizneseve të mëdha që u nxorën në tregun e hapur të energjisë elektrike dhe që nuk kanë nënshkruar kontratë me furnizues të licencuar, po diskutohet për padi të reja. Teksa përmendën se faturat në kuadër të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit i morën me një muaj vonesë, në Dhomën e Tregtisë dhe Industrisë thanë se faturat u shkuan edhe bizneseve pa kontrata. “Kompanive të cilave vetëm se u ka ardhur fatura e energjisë kanë të drejtë tash me ngritë padi, për shkak se këto nuk kanë kontratë me KEK-un, këto kanë pasur kontratë me KESCO-n, sepse KESCO ta ka sjellë faturën, por tash bizneset po thonë që faturat u kanë ardhur me emër të KEK-ut, me logo të KEK-ut dhe nga emaili i KEK-ut. Këtë duhet padyshim ta sqarojnë juristët”, ka thënë Kushtrim Ahmeti, drejtor i Dhomës së Tregtisë dhe

Industrisë. Pasi Gjykata Komerciale nxori aktgjykim për anulimin në tërësi të njoftimit të ZRrE-së për hapjen e tregut, bizneset po shohin mundësitë e kompensimit për “faturat me çmime të ngritura”. “Juristët tërë kohën kanë insistuar që bizneseve që u ka ardhur fatura me superçmim të ngritur, duhet të kërkojnë dëmshpërblim, duhet ta kthejnë prapa, jo ta paguajnë, shkak u nuk ka biznesi kontratë me KEK-u”, ka thënë për RTV Dukagjini, Ahmeti. Por, KEK-u, ndërmarrje e cila në kuadër të obligimit ligjor si Furnizues i Mundësisë së Fundit u kishte bërë thirrje bizneseve që kishin mbetur pa furnizues nga 1 qershori të nënshkruajnë kontrata të përkohshme, nuk u përgjigj në pyetjet e televizionit lidhur me këtë temë. Referuar Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, juristi Ardian Bajraktari sqaroi dispozitat lidhur me pasojat



eventuale, por shtoi se duhet pritur vendimin përfundimtar. “Pasoja e anulimit të një akti administrativ mund të jenë edhe prapavepruese, për dallim prej shfuqizimit kur pasoja e një akti të tillë janë vetëm për të ardhmen. Mirëpo, megjithatë për këtë duhet pritur që i njëjti të marrë formën e prerë. E deri në

këtë stad të procesit, tashmë i njëjti është i pezulluar dhe rrjedhimisht nuk mund të zbatohet, përkatësisht të prodhojë asnjë efekt”, ka thënë Ardian Bajraktari, jurist. Sidoqoftë, bizneset që u nxorën në tregun e hapur nga 1 qershori u furnizuan me energji elektrike në kuadër të FMF-së për

periudhën 60 ditore të paraparë me ligj dhe nuk janë shqyçur as pas përfundimit të saj. Zyra e Rregullatorit për Energji ende nuk ka dalë me njoftim lidhur me aktgjykimin e Gjykatës Komerciale për “anulimin në tërësi” të njoftimit të saj, ndërsa nuk ka qartësi nga kush dhe si po furnizohen bizneset.

RRETH 90 FERMERË KULTIVOJNË 100 HEKTARË ME ARONI

PRISHTINË, 2 SHTATOR - Kryeministri në detyrë, Albin Kurti, bashkë me ministrin në detyrë të Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Faton Peci, zëvendësministrin e këtij dikasteri, Imri Demelezi dhe deputetë të Kuvendit, mori pjesë në shënimin e Ditës së Aronisë Organike, që u organizua nga Shoqata Nacionale e Pemëve të Imëta “Mjedra e Kosovës” bashkë me “ArtiFruit&Aronica”. Në fjalën hyrëse, kryeministri Kurti tha se kjo ngjarje është dëshmi e përkushtimit dhe vizionit, për një kulturë bujqësore të re në vendin tonë dhe për zhvillimin e bujqësisë së qëndrueshme, në veçanti të bujqësisë organike në Kosovë.



“Sot po promovojnë një produkt relativisht të ri për Kosovë, por edhe të prodhuar në një sistem të ri alternativë, siç është sistemi i

prodhimit organik apo BIO apo ekologjik siç quhet ndryshe”, tha kryeministri Kurti, duke shtuar se aronia në Kosovë filloi të

kultivohej në vitin 2011 dhe brenda një periudhe të shkurtër kohore, falë punës së palodhur e të kujdesshme të fermerëve tanë dhe mbështetjes së partnerëve ndërkombëtarë, sektori i aronisë dhe ai i bujqësisë organike ka marrë formë të qëndrueshme dhe sot rreth 90 fermerë kultivojnë 100 hektarë me aroni, shumica sipas standardeve organike. Më tej, kryeministri Kurti theksoi se brenda një viti prodhimet tona do ta kenë logon dhe standardet organike të Republikës së Kosovës, meqenëse deri tani fermerët tanë janë certifikuar me standarde organike nga Bashkimi Evropian dhe vende të tjera. Ai tha se përkrahja e madhe financiare,

si asnjëherë më parë, me mbi 535 milionë euro për Ministrinë e Bujqësisë gjatë mandatit tonë qeverisës, duhet plotësuar me infrastrukturë tjetër të domosdoshme krahas lehtësirave burokratike. Kryeministri Kurti ritheksoi mbështetjen e qeverisë për fermerët, për bizneset agro-ushqimore dhe për të gjithë ata që po kontribuojnë në këtë sektor meqë, siç tha ai, aronia dhe pemët e imëta nuk janë vetëm kultura bujqësore, ato janë pjesë e së ardhmes sonë ekonomike dhe shembull i asaj se si mund të zhvillohet Kosova në mënyrë të shëndetshme, të qëndrueshme dhe me perspektivë evropiane.

“Trepça” rikthen 11 hektarë pronë në Hajvali, vlera mbi 23 milionë euro

PRISHTINË, 2 SHTATOR - Pas përfundimit të fazës së kthimit të pronave nën menaxhim “Trepça Sh. A.”, për herë të parë pas luftës ka filluar procesi i lirimit të pronave në Zonën

Kadastrale Hajvali. “Fjala është për një sipërfaqe prej 11 hektarësh, pronë e Trepçës, me një vlerë tregu mbi 23 milionë euro. Ky është vetëm fillimi i procesit të rikthimit të pasurisë

së Trepçës dhe vënies së saj në funksion të zhvillimit e të ardhmes së ndërmarrjes”, ka njoftuar Trepça, duke njoftuar se së shpejti kjo pronë do të ofrohet për shfrytëzim të

përkohshëm. Palët e interesuara do të ftohen zyrtarisht për të aplikuar në përputhje me procedurat ligjore dhe parimet e transparencës.



SI RUSIA SHKAKTON HUMBEN E SINJALIT SATELITOR NGA AEROPLANËT EVROPIANË: ANTENA 40 METRA DHE STACIONE MOBILE



Një antenë gjigante 40 metra e lartë, e vendosur në Kaliningrad, pranë kufirit me BE-në, është bërë burimi kryesor i ndërhyrjeve në sinjalin GPS të avionëve dhe anijeve europiane.

Një strukturë e madhe, pothuajse anonime, është shfaqur pranë fshatit Okunevo në Kaliningrad, rajoni rus që kufizohet me Poloninë dhe Lituaniën. Vetëm 98 kilometra larg nga qyteti polak i Gdanskut, kjo antenë është identifikuar si një nga burimet më të mëdha të ndërhyrjeve në sistemet e navigimit satelitor që nga viti 2022, kur Rusia nisi pushtimin në shkallë të gjerë të Ukrainës, shkruan "Corriere della Sera".

Triangulime, satelitë dhe tension në NATO: Propozime për "ta neutralizuar"

Zbulimi i antenës nuk ka qenë i lehtë. Ekspertët ndërkombëtarë janë detyruar të përdorin triangulime të avancuara dhe imazhe satelitore për ta lokalizuar. Burime të larta në Bruksel (ku ndodhet selia e NATO-s), kanë zbuluar për Corriere della Sera se gjatë viteve 2023-2024, është propozuar deri në "neutralizimin" e antenës, një veprim më simbolik sesa ushtarak. Por ideja është hedhur poshtë, kryesisht për shkak të kundërshtimeve nga

SHBA-të dhe frikës për përshkallëzimin e konfliktit me Rusinë.

Një rrjet i tërë stacionesh, fikse dhe të lëvizshme

Antena e Kaliningradit nuk është e vetmja. Pikë të tjera të ngjashme janë identifikuar në Baltiysk, Yantarnyy, afër Shën Petersburgut dhe në kufirin me Ukrainën. Në qershor, Estonia akuzoi Moskën për vendosjen e pajisjeve të tjera vetëm 20 kilometra larg kufirit të saj. Sipas hetimeve, pajisjet e ndërhyrjes kontrollohen nga njësi të specializuara të luftës elektronike: Brigada e 16-të në Kursk (afër kufirit me Ukrainën) dhe Regjimenti i 218-të. Disa janë stacione të lëvizshme, të maskuara, por të dukshme për satelitët.

Linjat ajrore europiane, të goditura prej më shumë se tre vitesh

Që prej vitit 2022, dhjetëra avionë që udhëtojnë midis Europës dhe Lindjes së Mesme kanë raportuar probleme serioze me sistemet satelitore të navigimit. Në teori, Rusia përdor këto ndërhyrje për të penguar dronët ukrainas, por efektet anësore kanë prekur avionët dhe anijet

civile.

Sipas Universitetit të Stanfordit, gjatë gushtit të kaluar, 90 deri në 150 avionë në ditë janë përballur me probleme teknike serioze. Ndërkohë, organizata OpsGroup tregon se një vit më parë, rreth 1.400 fluturime në ditë humbnin sinjalin GPS në hapësirat ajrore të Europës, Lindjes së Mesme dhe Rusisë.

Rritje alarmante: +220% humbje të sinjalit GPS që nga 2021

Sipas IATA-s (Shoqata Ndërkombëtare e Linjave Ajrore), numri i incidenteve me humbje të sinjalit është rritur me 220% mes viteve 2021-2024, me një mesatare prej 56.3 raste për çdo 1.000 fluturime vetëm vitin e kaluar.

Si funksionon ndërhyrja: Jamming dhe Spoofing

Ndërhyrjet ndodhin kryesisht në dy forma:

Jamming: Bllokimi i plotë i sinjalit GPS;

Spoofing: Dërgimi i të dhënave të rreme, duke mashtruar sistemin e avionit për pozicionin e tij real. Këto ndërhyrje kanë shkaktuar devijime të fluturimeve (siç ndodhi me një avion të Ryanair në janar që u devijua nga Lituania në Poloni), anulime rrugësh ajrore (Finnair pezulloi për një muaj fluturimet për në Tartu, Estoni), dhe madje edhe mbyllje të përkohshme aeroportesh.

Në një rast, edhe avioni i Ursula von der Leyen u përball me probleme gjatë zbritjes në hapësirën ajrore të Bullgarisë.

Ekspertët paralajmërojnë: Ndërhyrjet po sofistikohen

"Ndërhyrjet po bëhen gjithnjë e më të shpeshta dhe më të ndërlikuara," tha Jesper Rasmussen, drejtor në EASA (Agjencia Europiane për Sigurinë e Aviacionit). Spoofing ka prekur sisteme kritike në avionë: nga menaxhimi i fluturimit, deri te sistemet anti-përplasje, radarët e motit dhe transponderët që japin të dhënat e avionit në kohë reale.

Thirrje për ndërhyrje ndërkombëtare, por Rusia ka ndikim edhe në OKB

Duke parë rrezikun në rritje, kompanitë ajrore kërkojnë ndërhyrje nga ICAO (Agjencia e OKB-së për Aviacionin Civil Ndërkombëtar). Por edhe aty, Rusia ka rol të rëndësishëm, duke e bërë çdo vendim të vështirë.

Nick Careen, zëvendës-president i IATA-s, tha se "Me tensionet gjeopolitike që po rriten, është e vështirë të imagjinohet një zgjidhje afatshkurtër për këtë fenomen."



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

Jesper Ostlund, selektor i ri i Kosovës, Zhuta, ndihmës i tij

PRISHTINË, 2 SHTATOR - Jesper Ostlund është selektor i ri i Kombëtares së Kosovës në hendboll (meshkujt). Suedezi Ostlund është paraqitur të martën në konferencën për medie të mbajtur në Prishtinë. Ostlund ka karrierë të suksesshme si trajner në Suedi, ndërsa tani do ta drejtojë edhe kombëtaren tonë. Ai e udhëheq prej vitit të kaluar skuadrën elitare të Suedisë, Hallby, me të cilën ka arritur suksese historike. Hallbyn e ka

drejtuar edhe prej vitit 2018 deri në vitin 2022. Më pas për dy vjet ishte trajner i klubit të njohur suedez Savehof. Me Savehofin i fitoi dy tituj të kampionit dhe dy kupa të Suedisë në konkurrencë të femrave. Ka drejtuar me sukses të plotë edhe kombëtares e grupmoshave të reja të Suedisë. Konferencën për shtyp e hapi presidenti i FHK-së, Edin Kolgeci. Ai falënderoi shtabin teknik të deritashëm, që udhëhoqej nga Bujar

Qerimi. Ka vlerësuar punën e Qerimit dhe ndihmësve të tij, por ka theksuar se është vendosur për trajner tjetër me synim për ta ngritur kombëtaren në nivel edhe më të lartë. Kolgeci ka paraqitur para gazetarëve disa prej sukseseve të selektorit të ri, Ostlund, dhe asistentit të tij, Jasmin Zhuta. Ostlund në edicionin e kaluar e ka udhëhequr për herë të parë në histori Hallbyn drejt plejofit të kampionatit suedez. Në vitin

2020 u shpall trajner i vitit në Suedi në konkurrencë të meshkujve. Hallbyn e promovoi në elitë pas 53 vjetësh, në vitin 2019. Me Savehofin ishte trajner në Ligën e Kampionëve, ndërsa me kombëtaret e reja të Suedisë kishte vend të katërt, të pestë, të gjashtë e të shtatë në kampionate evropiane. Jasmin Zhuta, po ashtu, ka karrierë impesive në Suedi. Ka drejtuar klube të ndryshme dhe shquhet për punën individuale. Zhuta



është shqiptar me prejardhje nga Maqedonia e Veriut. Ai është krenar që do të punojë te Kosova. Ostlund ka folur për synimet me Kosovën. Ka thënë se synimi kryesor është kualifikimi në një ngjarje të madhe, Evropian apo Botëror.

‘DARDANËT’ VAZHDOJNË STËRVITJET, S’MUNGON OPTIMIZMI PËR NDESHJEN NDAJ ZVICRËS

EPOKA E RE

Veton ZYMBERI

Prishtinë, 2 shtator - Përfaqësuesja e Kosovës në futboll ka mbajtur edhe stërvitjen e dytë para ndeshjeve të shtatorit. Siç dihet, Kosova përballet për kualifikueset e Kupës së Botës 2026, fillimisht më 5 shtator me Zvicrën në Bazël dhe tri ditë më vonë me Suedinë në stadiumin “Fadil Vokrri”. Në këtë stërvitje që u mbajt në Kampin Nacional të FFK-së në Hajvali, përgjegjësi Franco Foda u përqendrua kryesisht në aspektet taktike,

duke punuar me ekipin në mënyrën e lojës që synon ta aplikojë në sfidën e parë kundër Zvicrës. Futbollistët Fidan Aliti dhe Ron Raqi janë stërvitur vetëm në një pjesë të stërvitjes me program të diferencuar, pasi janë grumbulluar me vonesë. Pas stërvitjes kanë folur futbollistët Dion Gallapeni dhe Meriton Korenica. “Stërvitjet janë duke shkuar me intensitet të lartë. Jemi duke u përgatitur për këto dy ndeshje, por normalisht fokusi për momentin është vetëm te Zvicra. Jemi duke punuar në aspektin taktik, kështu që

shpresojmë të shkojmë atje dhe të marrim rezultat pozitiv. Pres që në ndeshjen me Zvicrën të hyjmë në fokus maksimal sepse e dimë se është ndeshje e vështirë dhe shpresoj se me ndihmën e bashkatdhetarëve tanë të marrim rezultat pozitiv”, ka thënë Gallapeni. Optimizëm për dy ndeshjet ka shprehur edhe Meriton Korenica, i cili pret përkrahje të madhe nga shqiptarët që jetojnë në Zvicër. “Po përgatitemi maksimalisht për këto dy ndeshje. Stërvitja sot ka shkuar shumë mirë. Të gjithë djemtë janë të motivuar për ndeshjen e



parë. Shpresoj të bëjmë më të mirën dhe të japim maksimumin pasi dihet se është një ndeshje e vështirë, por gjithçka po shkon shumë mirë dhe shpresoj ta japim maksimumin dhe të marrim

rezultat pozitiv. Janë dy kombëtare shumë të forta, si Zvicra ashtu edhe Suedia, por presim rezultate pozitive, pasi kemi një grup shumë të mirë të lojtarëve. Të gjithë janë të motivuar dhe mezi i presin ndeshjet. Pres përkrahjen e të gjithëve në Bazel, pasi atje ka shumë shqiptarë dhe shpresoj ta bëjmë më të mirën dhe t'i kënaqim edhe ata që do të vijnë ta shikojnë ndeshjen”, ka thënë Korenica. “Dardanët” stërvitjen e radhës e mbajnë sot (e mërkurë) nga ora 11:00 në Kampin Nacional të FFK-së në Hajvali.

NISIN PUNIMET NË STADIUMIN E SUHAREKËS, KURTI: PËRFUNDON BRENDË 750 DITËSH

SUHAREKË, 2 SHTATOR - Në Suharekë kanë nisur punimet për ndërtimin e stadiumit të këtij qytetit i cili do t'i ketë mbi 6 000 ulëse dhe do të kushtojë 11 milionë euro. Në vënien e gurthemelit, kryeministri në detyrë i Republikës së Kosovës, Albin Kurti, ka thënë se ky stadium pritet të përfundojë brenda 750 ditësh dhe do të jetë i kategorisë D sipas standardeve të UEFA-s. “Jemi bashkë në Suharekë për vënien e gurthemelit të stadiumit i cili është i kategorisë D sipas UEFA-s. Do të ketë më shumë se 6 mijë e 500 ulëse. Një lajm i

jashtëzakonshëm për Suharekën dhe futbollin e sportin e Kosovës. Morëm vesh që për 750 ditë do të kryhen të gjitha punimet e nevojshme në mënyrë që, ashtu siç duket në projekt, të duket edhe në realitet. Ne me këtë stadium, i cili e ka vlerën e gjithëmbarshme të investimit rreth 11 milionë euro, lajmë një pjesë të borxhit shtetëror për këtë ekip të jashtëzakonshëm që padyshim se po frymëzon që sa më shumë të rinj e të reja të merren me sport”, ka thënë Kurti.

Ndërsa ministri në detyrë i



Sportit, Hajrulla Çeku, ka deklaruar se ky është një investim shumë i rëndësishëm

për qytetin e Suharekës. Ai ka treguar se investime të tilla janë pjesë e një programi shumë më të madh të Qeverisë së Kosovës për përmirësimin e infrastrukturës sportive në vend. “Ky investim është pjesë e një programi shumë më të madh të Qeverisë së Kosovës, jo vetëm i ministrisë. Buxheti për infrastrukturën e futbollit ka kërkuar zotim të veçantë dhe kryeministri e ka kuotuar rëndësinë që e ka futbollit për shtetin tonë. Jemi duke investuar në shumë qytete të Kosovës. Disa stadione tashmë në realizim, disa përfundojnë

shumë shpejt, të tjerat nisin ndërkohë. Jam shumë i lumtur që Suharekës po ia nisim këtë investim shumë të rëndësishëm bashkë me fushën ndihmëse që tashmë është në përfundim e sipër”, ka deklaruar Çeku. I lumtur për këtë projekt ishte edhe kryetari i komunës së Suharekës, Bali Muharremaj, i cili tha se ky qytet e meriton të ketë kushte shumë më të mira infrastrukturore në sport. Në këtë stadium pritet që ndeshjet t'i zhvillojnë skuadra e Ballkani, ajo e Suharekës dhe klube të tjera të kësaj komune.

FBK: Shorti për edicionin e ri hedhet më 12 shtator

PRISHTINË, 2 SHTATOR - Federata e Basketbollit e Kosovës ka bërë me dije se më 12 shtator do të zhvillohet ceremonia e hedhjes së shortit për edicionin e ri të garave në basketbollin e Kosovës. Ky hap shënon nisjen zyrtare të përgatitjeve për

sezonin e ri i cili pritet të sjellë emocione dhe rivalitet të lartë në parket. Sipas njoftimit zyrtar nga FBK-ja, ceremonia do të zhvillohet në ambientet e federatës në Prishtinë, ku fillimisht, nga ora 11:00, do të tërhiqet shorti për Superligën e

Femrave. Më pas, në orën 12:00, do të vijojë shorti për Superligën, liga më e lartë e basketbollit të meshkujve në Kosovë. Me hedhjen e shortit do të përcaktohen çiftet e para të kampionatit të ri, ndërsa klubet do ta marrin informacionin

zyrtar mbi kalendarin fillestar të ndeshjeve, përfshirë datat dhe përballjet që do ta hapin sezonin. Sezoni i ri 2025/26 pritet të jetë një nga më të fortët dhe më të balancuarit në vitet e fundit, me shumë skuadra që janë përforcuar ndjeshëm gjatë



merkatos verore. Pothuajse të gjitha skuadrat veç se i kanë filluar stërvitjet dhe po presin fillimin e këtij edicioni.

Isak: Dua të fitoj gjithçka me Liverpoolin

LIVERPOOL, 2 SHTATOR - Alexander Isak zyrtarisht është futbollist i Liverpoolit, me suedezi që vendos menjëherë një rekord të ri në Angli, si blerja më e shtrenjtë në histori. Trajneri Arne Slot e kërkoi me insistim duke detyruar drejtuesit e klubit të paguajnë një shifër të

frikshme, 150 milionë euro, aq sa kërkonte Newcastle. Me këtë blerje Liverpooli hap një kapitull të ri në ishull, por jo vetëm kaq, pasi me këtë shumë të shpenzuar, Isak bëhet lojtari i tretë më i shtrenjtë në historinë e futbollit, pas Neymarit dhe Mbappes. Në Liverpool, Isak

do të mbajë ta veshur fanellën me numrin 9, por klubi i kuq nuk zbuloi detaje të tjera të kontratës duke u mjaftuar me faktin se lojtari ka nënshkruar një kontratë me terma afatgjatë. Ish-futbollisti i Newcastle's nuk e fshehu lumturinë për këtë transferim. “Ishte një rrugë e gjatë për të

arritur deri këtu. Jam i lumtur të jem pjesë e këtij ekipi, i këtij klubi. Jam krenar, mezi pres të filloj”, u shpreh Isak për faqen zyrtare të klubit duke shtuar: “Mendoj se kam shumë për të dhënë, por dhe për t’u përmirësuar. Do ta jap maksimumin për këtë ekip. Dua të fitoj gjithçka”.



Zhegrova: Ëndrra ime u bë realitet, dua gola dhe tituj

TORINO, 2 SHTATOR - Edon Zhegrova është tashmë futbollist i Juventusit. Pas njoftimit zyrtar, sulmuesi nga Kosova ka dhënë edhe intervistën e tij të parë si bardhezi, duke shprehur emocionet e mëdha për këtë hap të rëndësishëm në karrierë. Transferimi i tij nga Lille u mbyll për një shumë totale prej rreth 18.5 milionë eurosh, duke përfshirë ofertën bazë, kostot shtesë dhe bonuset. Marrëveshja u finalizua paralelisht me shitjen e Nico Gonzalezit tek Atletico Madridi për 33 milionë euro. Pas përshëndetjes me tifozët, vizitave mjekësore dhe firmës në kontratë, Zhegrova u paraqit me fjalë plot entuziazëm. “Për mua është një ëndërr. Jam krenar dhe i nderuar që do ta vesh këtë fanellë. Ky është një moment i jashtëzakonshëm për mua dhe familjen time”, ka thënë ai për kanalet zyrtare të klubit. Sa i përket rolit të tij në fushë, kosovari ishte i qartë: “Pozicioni im i preferuar është anësor i djathtë. Më pëlqen të shënoj gola, të jap asistime dhe t’i



ndihmoj shokët e skuadrës me cilësitë e mia”. Zhegrova kujtoi edhe përballjen me Juventusin në Ligën e Kampionëve sezonin e kaluar: “Ishte një ndeshje e madhe, shumë e vështirë. Tani jam i lumtur që jam këtu dhe mezi pres t’i njoh shokët e skuadrës”. Në fund, ai foli për objektivat e tij: “Dua të shënoj

shumë gola dhe mbi të gjitha të fitoj tituj. Me cilësinë që ka kjo skuadër, besoj se mund t’ia dalim”. Me këtë prezantim, Juventusit fiton një lojtar plot energji dhe ambicie, ndërsa Zhegrova nis një aventurë të re ku synon të lërë gjurmë në futbollin italian dhe në atë evropian.

Piastri: Janë ende 9 gara, 34 pikë nuk është një avantazh i mjaftueshëm

AMSTERDAM, 2 SHTATOR - Gara e Çmimit të Madh të Holandës në Formula 1 ishte një bekim për pilotin austrian të McLarenit, Oscar Piastri, që fitoi në pistën e Zandvoort. Nga ana tjetër, rivali dhe shoku i tij i skuadrës, Lando Norris, u detyrua të tërhiqej pas një problemi në makinë. Për pasojë, Piastri udhëheq me 34 pikë në renditjen e përgjithshme, duke hedhur një hap të madh drejt titullit kampion për pilotë. Një epërsi që vetë austriani nuk e shpresonte para kësaj gare, ndërkohë që janë ende edhe 9 gara deri në fund të sezonit. Duke folur për këtë situatë, Piastri këmbënguli t’i mbante këmbët fort në tokë, duke përjashtuar mundësinë e spekulimit tani për avantazhin e tij. “Ka ende shumë rrugë për të bërë. Duhet të vazhdoj të shtyj



përpara dhe të përpiqem të fitoj gara”, ka thënë austriani. “Nuk do të thosha se është një diferencë shumë e rehatshme. Gjithçka mund të ndryshojë shumë shpejt në Formula 1, me vetëm një dalje nga gara. Pra, me kaq larg për të shkuar në kampionat, nuk është një

avantazh i rehatshëm”, ka pohuar Piastri. Deri më tani këtë sezon asnjë pretendent për titull nuk ka pasur një diferencë kaq të madhe ndaj rivalit më të afërt. Ndërsa hyjmë në një të tretën e fundit të sezonit, me vetëm dy gara evropiane të mbetura, ky avantazh nuk është pak.

SHKURT

City e zyrtarizon portierin Donnarumma

Gianluigi Donnarumma është futbollist i ri i Manchester Cityt. Lajmin e ka bërë me dije vetë klubi anglez përmes kanaleve zyrtare. Portieri italian i ka kushtuar klubit anglez rreth 28 milionë euro. “Manchester City e ka nderin të njoftoj për transferimin e Gianluigi Donnarumma nga Paris Saint-Germain. Portieri italian, 26 vjeç, ka nënshkruar kontratë pesëvjeçare, e cila do ta shohë atë duke qëndruar në Etihad Stadium deri në verën e vitit 2030. Gjatë karrierës së jashtëzakonshme, italiani e ka fituar një reputacion si një prej portierëve më të mirë në futbollin evropian. I gjatë, imponues dhe komandues, me 195 centimetrat e tij, Donnarumma arrin në Etihad i fortë dhe me një përvojë të nivelit elitare”, ka njoftuar Manchester City.

Interi zyrtarizon transferimin e Akanjit nga City

Interi ka konfirmuar zyrtarisht transferimin e mbrojtësit Manuel Akanji nga Manchester City. Zikaltrit kanë bërë një goditje në minutat e fundit të afatit kalimtar duke transferuar zviceranin Akanji nga City. Megjithatë, zyrtarizimi i tij është bërë vetëm të martën, me Interin që ka ndarë hollësitë në faqet zyrtare. “Manuel Akanji është lojtar i ri i Interit. Mbrojtësi zviceran, i lindur në vitin 1995, ka ardhur në huazim nga Manchester City me një opsion për ta bërë marrëveshjen të përhershme, e cila do të bëhet një detyrim nëse plotësohen disa kushte”, thuhet në njoftimin e klubit. Sipas medieve italiane, Interi do t’i paguajë një milion euro Manchester Cityt për huazimin njëvjeçar, me opsionin për 15 milionë euro të tjera nëse Interi fiton Serinë A.

Jackson: Bayerni është një nga klubet më të mira në botë

Nicolas Jackson është zyrtarisht lojtar i Bayern Munchenit. 24-vjeçari senegalez u bashkua me gjermanët nga Chelsea në formë huazimi dhe do ta veshë fanellën me numër 11. “Jam shumë i lumtur që jam pjesë e këtij klubi të madh. Bayerni është një nga klubet më të mira në botë. Të gjithë i njohin emrat e legjendave që kanë luajtur këtu dhe e dinë se ky klub është sinonim i suksesit të madh. Kam qëllime dhe ëndrra të mëdha këtu dhe do të jap gjithçka nga vetja për ta ndihmuar Bayernin të fitojë më shumë tituj”, ka thënë Jacksoni.

Rabiot përforcon Milanin

AC Milan ka njoftuar firmosjen e Adrien Rabiot nga Olympique Marseille deri në qershor 2028. Gjatë gjithë verës kishte sugjerime se Massimiliano Allegri, pavarësisht prej afrimeve të tjera, dëshironte ta kompletonte mesfushën me Adrien Rabiot. Francezi ishte pjesë kyçe e skuadrës së tij te Juventusit dhe italianin donte që ai të rikthehej në Serinë A. “AC Milan njofton afrimin e Adrien Rabiot nga Olympique Marseille. Mesfushori francez ka firmosur një kontratë me rossonerët deri më 30 qershor 2028”, thuhet në njoftimin e klubit kuqezi.

Johnsoni: Jordani është basketbollisti më i mirë i të gjitha kohëve në NBA

Magic Johnson, një nga legjendat e NBA-s, gjatë një eventi në Los Anxhelos ka folur për faktin se cili është basketbollisti më i madh i të gjitha kohëve. Për ikonën e

basketbollit amerikan nuk ka asnjë dyshim. “Lojtari më i mirë i të gjitha kohëve është Michael Jordan. Nuk kemi parë ende asnjë lojtar që të bëjë ato gjëra që bënte ai. I fortë fizikisht dhe

mjaft inteligjent në fushë”, ka thënë Magic Johnson. Më tej, sipas tij, në këtë renditje vijnë dy ikona të tjera të parketit si LeBron James dhe Kareem Abdul-Jabbar. “Këta të

dy plotësojnë podiumin e tre më të mirëve”, tha Johnsoni, pa harruar edhe Bill Russell, me 11 tituj kampionë në NBA. Magic Johnsoni nuk e ka përmendur emrin e Kobe

Bryantit në këtë listë të basketbollistëve më të mirë. Ky i fundit është ndarë nga jeta pak vite më parë pas një aksidenti dhe ka qenë mik me Magic Johnsonin.

Në bazë të Ligjit Nr 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike dhe të gjitha aktet tjera ligjore për ndryshim plotësimet e këtij ligji, si dhe bazuar në nenin 8 të Ligjit nr. 03/L- 212 të Punës, nenit 4 të Udhëzimit Administrativ nr 01/2024 për Rregullimin e Produrave për Themelimin e Marrëdhënies së Punës në sektorin publik, shpall:

KONKURS

KONKURS PËR VENDE PUNE

Titulli i punës:

- Koordinator i mirëmbajtjes

Entiteti : NPL “Tregu” Sh.A., Mitrovicë

Vendi: Mitrovicë

Afati për aplikim 15 ditë nga data 03.09.2025 deri më 18.09.2025

Përshkrim

NPL “Tregu” Sh.A., është ndërmarrje publike lokale në pronësi me 100% të aksioneve të saj nga Komuna e Mitrovicës. Të ardhurat e kësaj ndërmarrjes gjenerohen nga aktivitetet e hyrje -daljeve të ndërmarrjes. NPL “Tregu” Sh.A., është në kërkim të stafit mbështetës teknik me kualifikim, me integritet të njohurive, përvojë të nevojshme profesionale që do të kujdesen në ndërmarrje në përputhje me parimet e njohura profesionale.

Vendi i punës: Koordinator i mirëmbajtjes (20 orë në javë)

Përgatitja dhe shkathtësitë profesionale:

- Diplomë e shkollës së mesme
- Përparësi edukimi – certifikimi në fushën përkatëse
- Të jetë i gatshëm të punojë vetëm dhe me ekip
- Të dëshmojë aftësitë për të krijuar marrëdhënie të mira punë brenda dhe jashtë ndërmarrjes
- Nivel të lartë të motivimit dhe vetëiniciativës
- Nivel të lartë të etikës profesionale

Përgjegjësitë kryesore:

- Planifikimi dhe organizimi i mirëmbajtjes së hapësirës së tregut
- Përcaktimi i prioriteteve për riparime dhe përmirësime
- Mbikqyrja e teknikëve dhe stafit të mirëmbajtjes për të siguruar kryerjen e detyrave me efikasitet
- Monitorimi i pajisjve dhe inventarit
- Informimi i menaxhmentit për statusin e projekteve të mirëmbajtjes.

Procedurat e aplikimit:

- Aplikacioni për Punë
- CV-ja
- Dëshmi mbi përgatitjen profesionale
- Çertifikita e Lindjes (original)
- Letërnjoftimi (kopje)
- Përvoja e punës nga lëmia profesionale
- Vërtetimi se nuk jeni nën hetime dhe vërtetimi se nuk keni të kaluar kriminale

Vërejtje: I gjithë dokumentacioni merret në zyret e NPL “Tregu” , rr.Adem Voca, Mitrovicë si dhe duhet të dorëzohet i mbyllur në zarf.

Dokumentet e dorëzuara nuk kthehen.

Vetëm kandidatët që hyjnë në listën e ngushtë do të kontaktohen dhe ftohen për intervistë.

03.09.2025

Mitrovicë

Mitrovicë

NPL “Tregu” Sh.A.,



Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, Kompania kompanisë “Ariani Company” shpk, Vushtrri, në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe komunën organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për Pëlqim Mjedisor, – për Vendorsjen e Paneleve Solare Fotovoltaike me kapacitet 1.2 MWp, mbi Kulmin e Objekteve të Kompanisë “Ariani Company” shpk, në Z.K. Pestrovë, Vushtrri.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 16.10.2025 në ora 10:00 në Objektivin e Komunës së Vushtrrisë, adresa Sheshi “Ahmet Krasniqi” nr.10 42000 Vushtrri, do të organizohet debat publik nga Kompania kompanisë “Ariani Company” shpk, Vushtrri, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunën.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

<https://us05web.zoom.us/j/7012651943?pwd=JsyiMPR68pjZDwwrm2Z53eU1x9TEbu.1>

Meeting ID: 701 265 1943

Passcode: 123456

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për Kompaninë kompanisë “Ariani Company” shpk, Vushtrri, për Pëlqim Mjedisor, – për Vendorsjen e Paneleve Solare Fotovoltaike me kapacitet 1.2 MWp, mbi Kulmin e Objekteve të Kompanisë “Ariani Company” shpk, në Z.K. Pestrovë, Vushtrri.

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin

vnm.komente@rks-gov.net

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Gadaf Fetahu shpall te pavlefshme dëftesat dhe diplomën QK “11 Marsi” Prizren.

- Halis Ademi shpall te pavlefshme diplomën QK “11 Marsi” Prizren.

- Qendresa Kastrati shpall te pavlefshme dëftesën e kl V- IX shfmu “Brigada 125” Medvec

- Burim Buza shpall të pavlefshme diplomën e gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

- Lëshoj banesë me qira, pent-house. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.

- Lëshoj banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroi i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

- Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.

MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992





ROYAL CROWN

RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

Columbus, Georgia, USA
Since 1906

Columbus, Georgia, USA
Since 1906 0.5L